

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për caktimin e masës së shpërblimit për anëtarët e komisioneve zgjedhore në zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie të disa njësive vendore të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Ilirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y. Merkaj, M. Koja, V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **PD (M. Logu) LSI (A. Kaziaj)**
- **OJQ:** **KRIK**

Z. I. Celibashi: Përshëndetje, në seancën e sotme kemi në rendin e ditës për shqyrtim:

1. Projektvendimin “Për caktimin e masës së shpërblimit për anëtarët e komisioneve zgjedhore në zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie të disa njësive vendore të datës 6 Mars 2022”;
2. Projektvendim “Për miratimin e materialeve zgjedhore që do të përdoren për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 mars 2022”;
3. Projektvendim “Për miratimin e modeleve të dokumentacionit të punës që do të përdorin KZAZ-të për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar të datës 06 Mars 2022”;
4. Projektvendim “Për caktimin e njësive administrative ku do të krijohen selitë e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme vendore

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.01.2022*

për kryetar bashkie në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje të datës 6 Mars 2022”;

5. Për disa shtesa në udhëzimin nr.14, datë 9.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;

6. Projektvendim “Për emërimin e anëtarëve të KZAZ-ve”.

7. Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Dibër”;

8. Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tiranë”;

9. Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Dropull”;

10. Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë”;

11. Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Fier”;

12. Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Mat”.

Ndërkohë do të shtojmë në rendin e ditës projektvendimin që ka të bëjë me emërimin e anëtarëve të KZAZ-ve, propozime të Partisë Socialiste, Partisë Demokratike dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim.

Fillojmë me pikën e parë që ka të bëjë me projektvendimin “Për caktimin e masës së shpërblimit për anëtarët e komisioneve zgjedhore”. Shkurt zoti sekretar!

Z. Y. Merkaj: Referuar nenit 29, paragrafi 3 i Kodit Zgjedhor, KQZ përcakton me vendim masën e shpërblimit për punën që kryejnë anëtarët e komisioneve zgjedhore. Për caktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të komisioneve zgjedhore, vlerësohen kohëzgjatja dhe angazhimi, detyrat, përgjegjësitë dhe ngarkesa e punës, sipas nivelit të administratës zgjedhore dhe funksionit përkatës. Bazuar në përcaktimet e Kodit Zgjedhor konkretisht: neni 29, pika 6, neni 36, pika 2 dhe neni 95 i Kodit Zgjedhor kemi përcaktuar masën e shpërblimit për zgjedhjet vendore të datës 6 Mars 2022. Në këto kushte masa e shpërblimit referuar edhe vendimit nr. 38 datë 17.12.2020, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për caktimin e masës së

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.01.2022**

shpërblimit për anëtarët e komisioneve zgjedhore në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021”, është vendosur që për anëtarët e KZAZ-ve të jetë proporcionalisht me kohën e ushtrimit të detyrave në këto zgjedhje që janë zgjedhje të pjesshme. Ndërkohë masa e shpërblimit për anëtarët e KQV-ve dhe GN-ve ka mbetur e pandryshuar për shkak se angazhimi i tyre në zgjedhje nuk ndryshon. Në projektakt është parashikuar që Kryetari dhe zv.kryetari i KZAZ-së të shpërblehen në vlerën tridhjetë mijë lekë, nga momenti i konstituimit deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Anëtari dhe Sekretari i KZAZ-së në vlerën njëzet e pesë mijë lekë, nga momenti i konstituimit deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Kryetari i KQV-së në vlerën katër mijë lekë. Anëtari dhe Sekretari i KQV-së në vlerën tre mijë e pesëqind lekë. Anëtari i GNV-së në vlerën gjashtë mijë lekë. Për sa më sipër paraqesim projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Në parim diskutime për projektaktin? Jeni dakord besoj!? Përfaqësuesit e partive politike në lidhje me këtë projektakt?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Po dakord, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Në lidhje me përmbajtjen e aktit?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Edhe në lidhje me përmbajtjen, jemi njohur nëpërmjet komunikimit elektronik nga administrata dhe nuk kemi ndonjë objeksion.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Nuk kemi kundërshtime.

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.01.2022*

Z. I. Celibashi: Faleminderit, atëherë miratojmë projektaktin që ka të bëjë me caktimin e masës së shpërblimit për anëtarët e komisioneve sipas projektit të paraqitur dhe konkretisht:

Për kryetarin dhe zv. kryetarin e KZAZ-së masa e shpërblimit do të jetë tridhjetë mijë lekë;

Për anëtarin dhe sekretarin e KZAZ-së masa e shpërblimit do të jetë njëzet e pesë mijë lekë;

Për kryetarin e KQV-së masa e shpërblimit do të jetë katër mijë lekë.

Anëtari dhe Sekretari i KQV-së tre mijë e pesëqind lekë.

Anëtari i GNV-së gjashtë mijë lekë.

Vendimi nr. 11

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



**26.01.2022
Ora 17:47**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e materialeve zgjedhore që do të përdoren për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve** **Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ:** **Y. Merkaj, M. Koja, V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **PD (M. Logu) LSI (A. Kaziaj)**
- **OJQ:** **KRIK**

Z. I. Celibashi: Kalojmë tek pika e dytë e rendit të ditës!

Z. Y. Merkaj: Referuar nenit 99, pika 1, të Kodit Zgjedhor ku përcaktohet se KQZ-ja dërgon në selitë e KZAZ-ve, jo më vonë se tre ditë para datës së zgjedhjeve, materialet zgjedhore, të ndara në kuti të veçanta për çdo qendër votimi, ndër të cilat edhe lëndën e posaçme për timbrimin e zgjedhësit. Gjithashtu neni 99, pika 1, germa “a” i Kodit Zgjedhor përcakton se përveç kutive të materialeve zgjedhore, KZAZ-ve u jepen, kuti votimi për çdo qendër votimi, në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor, numër i mjaftueshëm kodesh sigurie, sipas vendimit të KQZ-së si dhe numër i mjaftueshëm dhomash të fshehta. Duke parë gjendjen dhe sasinë e kutive të votimit në magazinat e KQZ-së, rekomandohet përdorimi i kutisë së votimit dhe kutisë së materialeve zgjedhore, sipas modelit dhe specifikimeve teknike të miratuara në vendimin nr. 36, datë 17 Dhjetor 2020 të Komisionerit Shtetëror të

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.01.2022*

Zgjedhjeve dhe është pjesë përbërëse e këtij projektvendimi, sipas lidhjes 1, pjesa e parë dhe e dytë e vendimit nr. 36. Gjithashtu duke parë dhe sasinë e kodeve të sigurisë, rekomandohen kodet rezervë për mbylljen e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore, do të përdoren ato që janë miratuar me vendimin nr. 8, datë 12 Janar 2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve sipas modelit të këtij vendimi. Gjithashtu boja timbruese, duke parë sasinë e pamjaftueshme, mendohet që të prokurohet e të miratohet sipas modelit të miratuar me vendimin nr. 34, datë 16 Dhjetor 2020, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij projektvendimi. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe modelet përkatëse, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesit e partive politike në parim me projektaktin? Jeni dakord besoj!?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Po, në parim jemi dakord. Në përmbajtje, thjesht në lidhjen 1, të paktën në projektaktin që na është sjellë në rrugë elektronike, ka një referencë tek zgjedhjet për kuvend të datës 25 Prill 2021. Mendoj që është lapsus që duhet riparë, për të të bërë referencën “për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022”.

Z. Y. Merkaç: Jo nuk është lapsus, por modelet e bojës timbruese janë miratuar me këtë vendim për zgjedhjet e datës 25 Prill 2021, prandaj i jemi referuar atij vendimi dhe e kemi vendosur këtu.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Lexoj që ...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.01.2022*

Z. Y. Merkaj: Specifikimet e bojës timbruese janë sipas...

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021 si më poshtë...

Z. Y. Merkaj: Po, këtu po!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Besoj se ne po i miratojmë për zgjedhjet e pjesëshme vendore.

Z. Y. Merkaj: Kjo për zgjedhjet po...

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Është tek lidhja 1, pika 1! Thjesht për saktësi dokumentacioni, jo se ndryshon gjë tek thelbi i aktit.

Z. I. Celibashi: Të tjera nuk kemi, atëherë miratojmë projektaktin sipas përmbajtjes së propozuar.

Vendimi nr. 12

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



**26.01.2022
Ora 17:51**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e modeleve të dokumentacionit të punës që do të përdorin KZAZ-të për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve** **Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ:** **Y. Merkaj, M. Koja, V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **PD (M. Logu) LSI (A. Kaziaj)**
- **OJQ:** **KRIK**

Z. I. Celibashi: Kalojmë tek pika e tretë, për dokumentacionin e punës!

Z. Y. Merkaj: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, përcakton modelet e dokumentacionit të punës që do të përdorin Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor që do të ngrihen për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022 dhe për këqyrjen e materialit zgjedhor të dorëzuar nga KZAZ-të për nevoja të hetimit administrativ në KQZ. Referuar kjo ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Gjithashtu, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, në përmbushje të detyrave për administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në Zonën e Administrimit Zgjedhor, sipas parashikimeve të nenit 33 të Kodit Zgjedhor, regjistron në librin e protokollit të mbledhjeve informacionet ose pretendimet e subjekteve zgjedhore në zonë,

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**

**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.01.2022**

procesverbalet e mbledhjeve si dhe në regjistrin e vendimeve, vendimet e marra prej tij. KZAZ, në procesverbalin e konstatimit dokumenton të gjitha parregullsitë gjatë marrjes në dorëzim të kutive të votimit me fletët e votimit, dhe kutitë e materialeve të votimit si dhe të gjitha pasaktësitë e konstatuara gjatë procesit të numërimit të votave. Në vendimet që KZAZ-ja merr, janë:

Propozimi i kryetarit dhe zv. kryetarit të KZAZ-së;

Emërimi i anëtarëve të Komisioneve të Qendrave të Votimit;

Emërimi i kryetarëve dhe sekretarëve të Komisioneve të Qendrave të Votimit;

Shkarkimin nga detyra të anëtarëve të Komisioneve të Qendrave të Votimit;

Lirimin nga detyra;

Caktimin e qendrës së votimit;

Caktimin e numrit të grupeve të numërimit të votave... e me rradhë.

Gjithashtu KZAZ-ja dokumenton përmes procesverbaleve:

Marrjen në dorëzim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të materialeve të nevojshme për punën e KZAZ-së sipas parashikimeve të nenit 99;

Shpërndarjen e materialeve zgjedhore, sipas parashikimeve të nenit 100;

Marrjen në dorëzim nga të gjitha komisionet e qendrave të votimit, sipas parashikimeve të nenit 115;

Dorëzimin në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të ZAZ-së.

Të gjitha këto modele janë bashkëlidhur projektvendimit që po i paraqesim Komisionerit për shqyrtim dhe miratim. Në bazë të kompetencave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, është Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve që do të miratojë këtë dokumentacion, faleminderit!

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.01.2022*

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesit e partive politike në parim me projektaktin? Jeni dakord besoj!? Në përmbajtje keni ndonjë...

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Mendoj vetëm për të ruajtur koherencën dhe me vendimmarrjet e tjera. Titullin e vendimit, pas fjalës “kryetar” të shtohet “bashkie”, pra “për kryetar bashkie”. Tek pika e parë e vendimit pas fjalës “kryetar” të shtohet sërish “bashkie”. Për të qenë koherente dhe me vendimmarrjet e tjera që ka miratuar Komisioneri. I referohem gjithnjë dokumentit që na është dërguar, mbase administrata ka pas kohë dhe i ka riparë dhe ka bërë korrigjimet e nevojshme.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, përfaqësuesi i LSI-së?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Nuk kemi as në parim, as në thelb ndonjë gjë. Thjesht fakti që kur i referohemi kryetar në akt, merret vesh që i referohet bashkisë.

Z. I. Celibashi: Mirë atëherë miratojmë projektaktin “Për miratimin e modeleve të dokumentacionit të punës që do të përdorin KZAZ-të për zgjedhjet e pjeshme vendore për kryetar të bashkisë të datës 6 Mars 2022”, sipas draftit të propozuar.

Vendimi nr. 13

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



26.01.2022
Ora 17:54

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për caktimin e njësive administrative ku do të krijohen selitë e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie në bashkitë: Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Ilirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y. Merkaj, M. Koja, V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **PD (M. Logu) LSI (A. Kaziaj)**
- **OJQ:** **KRIK**

Z. I. Celibashi: Kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës, që ka të bëjë me caktimin e njësive administrative ku do të vendosen selitë e KZAZ-ve. Po zoti Sekretar!

Z. Y. Merkaj: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 33 të Kodit Zgjedhor si dhe në nenin 15 të Vendimit nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator, merr vendim për caktimin e njësive administrative ku do të krijohen selitë e Komisioneve të Zonës së Administrimit Zgjedhor. Njësitë administrative të përcaktuara në Lidhjen 1 të projektvendimit, ofrojnë barazlargësi nga qendrat e votimit në juridiksion e ZAZ-së përkatëse, lehtësi logjistike të transportit rrugor, duke ofruar kushte optimale për të krijuar Selitë e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.01.2022*

miratim si dhe listën e njësive administrative ku do të ngrihen selitë e KZAZ-ve, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesit e partive politike në parim me projektaktin? Jeni dakord besoj!? Në përmbajtje keni ndonjë...

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Dakord, kisha vetëm një pyetje për administratën. Nga zgjedhjet e datës 25 Prill 2021, ka pas ndonjë ndryshim në lidhje me selitë e KZAZ-ve, apo janë të njejta?

Z. Y. Merkaj: Nuk ka! Janë të njejta me ato të 25 prillit.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Nuk kemi ndonjë objeksion!

Z. I. Celibashi: Mirë, përfaqësuesi i LSI-së?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Jemi plotësisht dakord!

Z. I. Celibashi: Mirë, miratojmë projektvendimin “Për caktimin e njësive administrative ku do të krijohen selitë e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie në bashkitë: Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje, të datës 6 Mars 2022”, sipas draftit të propozuar.

Vendimi nr. 14

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



26.01.2022
Ora 17:56

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për disa shtesa në udhëzimin nr. 14, datë 9.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për caktimin e kritereve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjorë) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Ilirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y. Merkaj, M. Koja, V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **PD (M. Logu) LSI (A. Kaziaj)**
- **OJQ:** **KRIK**

Z. I. Celibashi: Kemi projektaktin që lidhet me disa ndryshime në udhëzimin nr. 14.
Po zoti Sekretar!

Z. Y. Merkaj: Referuar nenit 92/6, pika 3 dhe 92/7, të Kodit Zgjedhor, ku përcaktohet auditimi i fondeve dhe shpenzimeve të fushatës zgjedhore si dhe mënyrën e përzgjedhjes së ekspertëve kontabël të licensuar nga KQZ-ja. Gjithashtu referuar nenit 23/2 dhe 23/3, të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar, përcaktojnë mënyrën e caktimit të ekspertëve kontabël të licensuar, detyrimin e partive politike ndaj ekspertëve kontabël të licensuar, të cilët caktohen

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.01.2022**


nga KQZ-ja, publikimin e raporteve të auditimit nga koha e paraqitjes së raportit ose, sipas rastit, nga koha e mbylljes së procedurës së verifikimit si dhe mënyrën e pagesës së audituesve ligjorë, është hartuar projektudhëzimi “Për disa shtesa në udhëzimin nr. 14, datë 9.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Qëllim i këtij projektudhëzimi është ndryshimi në specifikimet e nevojshme për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Risi në këtë projektudhëzim është shtimi i termit “kandidatët për kryetar bashkie dhe këshilla bashkiakë”. Pjesa tjetër është pothuajse e pandryshuar ngavendimi. Edhe kontrata ka një rregullim me ndryshimin e ligjit të fiskalizimit është futur fatura e fiskalizuar. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim për ndryshimin e udhëzimit nr.14, datë 9.06.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Çfarë ndryshimi ka kontrata?

Z. Y. Merkaç: Kjo kontratë është miratuar me vendimin nr. 14 të Komisionerit Shtetëror. Duke qenë se tek vendimi nr.14 ka qenë për Zgjedhjet e datës 25 Prill 2021, kemi bërë një ndryshim për zgjedhjet për kryetar bashkie dhe këshillat bashkiakë, gjithashtu është futur dhe fatura e fiskalizuar, duke qenë se ka ndryshuar dhe ligji për lëshimin e faturës tatimore.

Z. I. Celibashi: Në lidhje me projektaktin në parim? Dakord besoj!? Për përmbajtjen? Dakord! Natyrshëm që për kohën e shkurtër në dispozicion dhe për natyrën e këtyre zgjedhjeve, përgjithësisht ndryshimet e disa akteve do të jenë vetëm ato që janë të imponuara nga natyra e zgjedhjeve që zhvillohen dhe data e zgjedhjeve. mirë do të ishte të kishim më shumë kohë në dispozicion për t’i riparë të gjitha aktet, por kjo do të mbetet për të ardhmen. Mirë meqenëse jemi dakord me

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.01.2022*

draftin e propozuar e miratojmë projektudhëzimin “Për disa shtesa në udhëzimin nr. 14, datë 9.06.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për caktimin e kritereve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”.

Vendimi nr. 15

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



26.01.2022
Ora 18:00

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për emërimin e anëtarëve dhe sekretarëve të komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie në bashkitë: Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje të datës 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Ilirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y. Merkaj, M. Koja, V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **PD (M. Logu) LSI (A. Kaziaj)**
- **OJQ:** **KRIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, që ka të bëjë me...

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Mundem?!

Z. I. Celibashi: Po zoti Logu!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Meqenëse të dyja subjektet politike që jemi të pranishëm nuk kemi ndonjë interes lidhur me zëvendësimet që do të bëhen, për shkak se nuk kemi zëvendësime nga partitë respektive. Në se është e mundur të kalojmë në vendimmarrjen që na intereson të dy subjekteve në lidhje me emërimin e anëtarëve të KZAZ-ve dhe më pas të vazhdoni me rendin e ditës.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.01.2022**

Z. I. Celibashi: Dakord, po procedojmë në këtë mënyrë, e drejtë. Atëherë, kemi projektvendimin “Për miratimin e anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve”.

Z. Y. Merkaj: Referuar nenit 7 të rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor, miratuar me vendimin nr. 5, dt.20.11.2020 të Komisionit Rregullator, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve emëron anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve. Duke qenë se në shortin e hedhur reflektuar në vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, janë përcaktuar tre partitë politike që do të paraqesin kandidaturat: Partia Socialiste, Partia Demokratike dhe Partia Lëvizja Socialiste për Integrim. Të treja këto parti kanë paraqitur kandidaturat për anëtarë të KZAZ-ve, sipas dhe shortit të hedhur në KQZ. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se është i plotë numri i anëtarëve të KZAZ-ve, sipas përcaktimeve PS, PD dhe LSI. Për shkak të kohës së shkurtër nuk ka qenë e mundur verifikimi i të gjithë kandidaturave për anëtarë të KZAZ-ve, jemi në proces verifikimi. Duke qenë se koha është e shkurtër ne po e fusim si akt meqenëse emrat janë të gjithë dhe deri nesër do të bëhet verifikimi përfundimtar i anëtarëve.

Z. I. Celibashi: Gjithësesi në çdo rast ne bëjmë një verifikim *prima-facie*, pastaj në ushtrim të funksioneve të tyre, në një verifikim të mëtejshëm, në se rezulton që ka probleme nuk na pengon për të vendosur qoftë për largime, qoftë për plotësim të dokumentacionit të nevojshëm. Koha e shkurtër për përgatitjen e këtyre zgjedhjeve imponon funksionalitet të plotë sa më shpejt të KZAZ-ve. Me siguri kjo duhet të rikonsiderohet në ndryshimet e Kodit Zgjedhor, kjo situatë.

Përfaqësuesit e partive politike në parim dakord me aktin? Në përmbajtje përfaqësuesi i Partisë Demokratike?

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.01.2022*

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti Celibashi dhe për mirëkuptimin për të ndryshuar rendin e ditës. Kishim, siç besoj i kam bërë me dije dhe administratës, nëpërmjet komunikimit me Sekretarin e Përgjithshëm, tek KZAZ-ja nr. 26 që përkon me Bashkinë Vorë, kemi kërkuar ndryshimin e anëtares së propozuar Enkelejda Xhakoni me anëtares Lavdie Keçi dhe kemi depozituar dokumentacionin përkatës, mjetin e identifikimit dhe diplomën e noterizuar. Vetëm këtë kisha, me gjithëshka tjetër jemi dakord.

Z. I. Celibashi: Mirë, përfaqësuesi i LSI-së?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Thjesht faktin që dakordësojmë me ju Kryetar, për sa i përket pjesës së organizimit të këtyre zgjedhjeve. Afatet ligjore na imponojnë që të sillemi sipas parashikimeve ligjore për sa i përket thelbit nuk kam ndonjë gjë tjetër.

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit miratohet projektvendimi “Për emërimin e anëtarëve dhe sekretarëve të komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie në bashkitë: Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje të datës 6 Mars 2022”,


Të propozuar nga Partia Socialiste sipas Lidhjes 1.

Të propozuar nga Partia Demokratike sipas Lidhjes 2.

Të propozuar nga Lëvizja Socialiste për Integrim sipas Lidhjes 3. Duke bërë ndryshimin e shënjuar nga përfaqësuesi i Partisë Demokratike.

Vendimi nr. 16

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



**26.01.2022
Ora 18:05**

RENDI I DITËS

**Projektvendim “Për plotësimin e vakancave në Këshillin e Bashkisë: Dibër,
Tiranë, Dropull, Lezhë, Fier, Mat”.**

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Ilirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y. Merkaj, M. Koja, V. Ballgjini**
- **Parti Politike:**
- **OJQ:** **KRIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikat e tjera të rendit të ditës, që kanë të bëjnë me plotësimin e vakancave në këshillat bashkiakë. Përfshijë në një relativitet këto!

Z. Y. Merkaj: Këshilli i Bashkisë: Dibër, Tiranë, Dropull, Lezhë, Fier, Mat kanë njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancave në këto këshilla, për shkak të dorëheqjes së disa anëtarëve të këshillave bashkiakë. Të gjashtë kandidatët e këshillave përkatës kanë depozituar në KQZ formularin e vetëdeklarimit. Nga verifikimi i tyre rezulton se asnjëri prej tyre nuk ka shënuar të dhëna që kanë të bëjnë me ndalimet e ligjit “Për garantimin e integritetit të personave që zgjedhin, emërohen, ose ushtrojnë funksione publike”. Për të gjashtë kandidatët për anëtarë të këshillave bashkiakë është kërkuar informacion nga zyrat e gjendjes civile dhe zyra e gjendjes gjyqësore. Në përgjigje të kërkesës sonë kemi marrë përgjigje që të gjashtë kandidatët nuk kanë ndryshime në përbërjen e gjendjes civile.

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.01.2022*

Gjithashtu Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka sjellë në KQZ, verifikimin e gjendjes gjyqësore të kandidatëve, ku rezulton se nuk kanë shënime në sistem, dmth janë të padënuar. Në këto kushte referuar pikës 2, të Kreut V të vendimit nr. 17 të vitit 2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet që të dhënat e kandidatëve për anëtarë të këshillave bashkiakë të mësipërm, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tyre në funksionin e këshilltarit. Në këto kushte, propozojmë emërimin e tyre në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimet për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Miratohet:

Projektvendimi që ka të bëjë me plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Dibër me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë zotin Besmir Fatmir Markeçi.

Vendimi nr.17

Projektvendimi për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tiranë me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë zotin Ramazan Halit Buci.

Vendimi nr.18

Projektvendimi për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Dropull me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Demokratia Sociale zotin Orest Filip Malo.

Vendimi nr.19

Projektvendimi për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Uniteti Kombëtar, zonja Armanda Hil Ndoka.

Vendimi nr.20

Projektvendimi për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Fier me kandidatin nga lista shumemërorë e Partisë Socialiste të Shqipërisë zotin Flavjo Lelo Gjonaj.

Vendimi nr.21

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.26.01.2022*

Projektvendimi për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Mat me kandidatin nga lista shumemërorë e partisë së Reformave Demokratike të Shqipërisë, zonja Arendina Qemal Gasa. **Vendimi nr.22**

Tjetër nuk kemi? Faleminderit, seanca mbyllet!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

